



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Veçantë



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 201500637/3

Tiranë ___/___/2015

Lënda : *Rekomandim për ndryshimin dhe përmirësimin e dispozitave të Rregullores "Për rregullat e hollësishme të sjelljes së punonjësve të Policisë së Burgjeve", miratuar me Urdhrin e Ministrit të Drejtësisë nr. 5251/2, datë 30.07.2010.*

Drejtuar : **Ministrit të Drejtësisë**
Z. Nasip NAÇO

Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve
Z. Artur ZOTO

Tiranë

Të nderuar zotërinj,

Në datën 24.04.2015 në Institucionin e Avokatit të Popullit është bërë një ankesë nga familjarët e shtetasit E.T.. Sipas tyre, shtetasi E.T. ishte akuzuar për veprën penale të "Mbajtjes pa leje të armëve luftarake dhe municioneve" dhe ndaj tij Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan kishte caktuar masën e sigurimit personal "arrest në burg". Meqënëse i arrestuari ishte plagosur me armë zjarri, ishte transferuar nga IEVP Elbasan në Spitalin e Traumës Tiranë me qëllim për t'i dhënë ndihmë mjekësore më të specializuar. Në këtë institucion shëdetësor i plagosuri i ishte nënshtruar një ndërhyrjeje kirurgjikale. Duke qënë me masën sigurimit personal "arrest në burg", në dhomën e spitalit ku ishte akomoduar i arrestuari ruhej nga punonjësit e Policisë së Burgjeve.

Familjarët e të arrestuarit pretendonin se, gjatë gjithë kohës që ai ndodhej në këtë spital mbahej i lidhur me pranga nga punonjësit e policisë duke ia vendosur ato në njërën dorë, tjetrën në këmbë dhe dy pjesët e tjera të prangave lidheshin në komedinë dhe në hekurat e krevatit. Sipas tyre, prangat i hiqeshin vetëm në rastet kur i arrestuari shkonte në tualet.

Gjithashtu ankuesit pretendonin se, në datën 24.04.2015, rreth orës 08:00, i arrestuari kishte patur hemoragji në vendin e operacionit. Ndodhur në këto

rrethana nga vëllai i tij dhe punonjësit e policisë ishte kërkuar ndihma e personelit mjekësor. Personeli mjekësor ka ndërhyrë menjëherë dhe ka vendosur që ta dërgojë atë në dhomën e urgjencës për ndërhyrje. Për të bërë të mundur lëvizjen e tij lindi nevoja e heqjes së prangave. Punonjësit e policisë kanë ndërhyrë për të bërë të mundur zgjidhjen e prangave, por njëra prej prangave e cila ishte e lidhur me dorezën e komedinës nuk ishte hapur. Në këto kushte, punonjësit e policisë dhe personeli mjekësor u detyruan që ta shoqëronin të arrestuarin për në sallën e operacionit me pranga në dorë dhe sirtarin e komedinës ku ishin lidhur ato. Pasi kanë mbërritur në sallën e operacionit të rasteve urgjente policët mundën të hapnin me çelës prangën e lidhur në sirtarin e komodinës.

Për të verifikuar këtë ankesë ndihmëskomisionerët e institucionit tonë shkuan në vend, në Spitalin e Traumës Tiranë. Nga pyetja e dy punonjësve të Policisë së Burgjeve Guxim Neza dhe Aqif Kurteshi u informuan se ata ishin caktuar me shërbim për të ruajtur dhe siguruar të arrestuarin E.T.. Faktin që i arrestuari mbahej lidhur me pranga në duar, këmbë dhe në krevat e komedinë e pranuan dhe e justifikuan se ky veprim ishte i parashikuar në Rregulloren “Për rregullat e hollësishme të sjelljes së punonjësve të Policisë së Burgjeve”, si dhe në instruktazhet e dhëna nga eprorët e tyre për kryerjen e kësaj detyrë. Gjithashtu ata informuan se, gjatë kësaj periudhe kohore që kryenin këtë lloj shërbimi kishin ardhur për kontroll edhe eprorët e tyre, të cilët e kanë parë personin e arrestuar që mbahej i lidhur me pranga.

Për të verifikuar bazueshmërinë e veprimit të punonjësve të Policisë së Burgjeve nga ana jonë u administrua kopja e Rregullores “Për rregullat e hollësishme të sjelljes së punonjësve të Policisë së Burgjeve”. Nga studimi i kësaj rregulloreje, e cila është miratuar me Urdhrin e Ministrit të Drejtësisë nr. 5251/2, datë 30.07.2010, rezulton se në nenin 30 (shoqërimi dhe transferimi i të burgosurve), pika 3, gërma “sh” e saj, ku bëhet fjalë për shoqërimin e të burgosurit në spitale, parashikohet se: *“I burgosuri i sëmurë, mbahet i lidhur me pranga nga njëra dorë ose këmbë, me hekurin e krevatit”*.

Sipas nesh, parashikimi i këtij veprimi ndaj një personi të burgosur apo të paraburgosur në këtë rregullore dhe zbatimi i tij në praktikë përbën një veprim jo human dhe trajtim çnjerëzor.

Nga shqyrtimi i këtij rasti, Avokati i Popullit e gjen me vend që të ndalet dhe të analizojë këtë fenomen negativ që cënon rëndë të drejtat themelore të individëve siç është ai i mbajtjes lidhur me pranga të personave të burgosur ose të paraburgosur të sëmurë në kushte spitalore.

Nga studimi i kuadrit ligjor në fuqi, vërejmë se procedura e mbajtjes të prangosur të personave të paraburgosur ose të burgosur nga Policia e Burgjeve në kushte spitalore, nuk është e drejtë dhe cënon thelbin e lirive të individit të garantuara nga Kushtetuta dhe Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut.

Sipas nenit 17 të Kushtetutës, *kufizime të të drejtave dhe lirive të parashikuara në këtë Kushtetutë mund të vendosen vetëm me ligj për një interes publik ose për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve. Kufizimi duhet të jenë në përpjestim me*

gjendjen që e ka diktuar atë. Këto kufizime nuk mund të çënojnë thelbin e lirive dhe të të drejtave dhe në asnjë rast nuk mund të tejkalojnë kufizimet e parashikuar në KEDNJ.

Sipas nenit 25 të Kushtetutës, askush nuk mund t'i nënshtrohet torturës, dënimit apo trajtimit mizor, çnjerëzor ose poshtëruës.

Ndërsa sipas nenit 28/5 të Kushtetutës, çdo person, të cilit i është hequr liria sipas nenit 27 ka të drejtën e trajtimit njerëzor dhe të respektimit të dinjitetit të tij.

Ne gjykojmë se, mbajtja e lidhur me pranga e një personi në gjymtyrë dhe në hekurat e krevatit është një veprim që përbën trajtim çnjerëzor dhe degradues.

Përfundimi i mësipërm gjen pasqyrim edhe në jurisprudencën e Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut, e cila në disa vendime të saj ka trajtuar problemin e përdorimit të prangave ndaj të arrestuarve të sëmurë. Kështu mund të përmendim rastet e mëposhtme:

Në Çështjen Mouisel kundër Francës, Aplikimi nr. 67263/01, datë 14 Nëntor 2002 dhe në Çështjen Henaf kundër Francës, Aplikimi nr. 65436/01, datë 27 Nëntor 2003, Gjykata shprehet se, mbajtja e personave të prangosur në kushte spitalore nuk justifikon gjithmonë qëllimet e sigurisë ndaj tyre. Akte të tilla janë konsideruar shpesh si jo humane dhe degraduese, veçanërisht për persona me një gjendje të rëndë shëndetësore si dhe bien në kundërshtim me nenin 3 të KEDNJ.

Konkretisht, në rastin e sipër përmendur, Mouisel kundër Francës, Gjykata ka vendosur që, në rastin konkret dhe të veçantë të paditësit, përdorimi i prangave mund të përbënte një trajtim degradues. Mouisel ka argumentuar se metoda e transferimit nga burgu në klinikën e specializuar, ka sjellë si rjedhojë një trajtim çnjerëzor dhe degradues, duke kërkuar kështu zbatimin e nenit 3.

Vendimi i Gjykatës, e cila vendosi në favor të kërkuarit dhe ka kundërshtuar pretendimet e qeverisë duke i vlerësuar si të gabuara, ka bërë të mundur krijimin e një precedenti që i ka dhënë një peshë të rëndësishme Raportit të Komitetit për Parandalimin e Torturës dhe të dënimeve ose trajtimeve çnjerëzore ose degraduese mbi burgjet Franceze, të bëra që nga 14 deri në 26 maj 2000.

Në Çështjen Istratii dhe të tjerët kundër Moldavisë, 27 mars 2007, nr. 8721/05, 8705/05 dhe 8742/05, Gjykata u shpreh se, fakti që ankuesi ishte prangosur në një radiator të spitalit, në pritje për të bërë operacionin, përbën shkelje të nenit 3 të KEDNJ.

Në Çështjen Koutcherouk kundër Ukrainës, nr. 2570/04, datë 6 Shtator 2007, ku Gjykata arriti në përfundimin që, ka shkelje të nenit 3 të KEDNJ, për shkak të mbajtjes së të pandehurit (i sëmurë me skizofreni) me duar të lidhura me pranga për 7 ditë, nga 9 ditët gjatë të cilave ka qënë në qeli izolimi.

Në disa çështje të tjera, si Assenov dhe të tjerët kundër Bullgarisë, 2 tetor 1998, § 93; Selmouni kundër Francës, 28 korrik, § 1999, § 95, Dakratas kundër Lituanisë, 10 tetor 2000, § 32; Labita kundër Italisë, 4 Prill 2000; Indelicato

kundër Italisë, 18 tetor 2001, Gjykata ka theksuar se, *ky nen përmban një garanci absolute, madje edhe në rastet më të vështira sikurse në luftën kundër terrorizmit ose krimin të organizuar dhe kjo është një e drejtë e domosdoshme, që nuk parashikon as kufizime as derogime, ndryshe nga sa ndodh me dispozitat e tjera të Konventës.*

Gjykata e Strasburgut ka përsëritur herë pas here në vendimet e saja se: *“Shqyrtimi i nenit 3 duhet të jetë vecanërisht i plotë dhe se duhet të ketë vëmendje maksimale në çështjet që kanë të bëjnë me të drejta të tilla si ato të përcaktuara në këtë nen të Konventës. (Çështja Ribitsch kundër Austrisë, 4 Dhjetor 1995, FQ 20 § 32); Neni 3 i KEDNJ ndalon në mënyrë absolute torturën, trajtimin ose ndëshkimin jo-njerëzor ose degradues pavarësisht nga sjellja e viktimës. Ai përmban një nga vlerat më themelore të shoqërisë demokratike. Natyra e krimin të kryer është e parëndësishme për sa i përket shqyrtimit të çështjes në bazë të këtij neni”* (Çështja V. e T. kundër Mbretërisë së Bashkuar, 16 Dhjetor 1999, fq 25, § 67).

Për pasojë, në të tilla raste, shteteve të përfshira në këto procese iu janë caktuar detyrime financiare për shkelje të nenit 3 të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut. Madje shpesh nëpërmjet këtyre vendimeve shtetet palë kanë marrë masa për të rishikuar kuadrin ligjor kombëtar duke caktuar standarde të pranueshme dhe të arsyeshme të sigurisë ndaj personit.

Gjithashtu theksojmë se, në disa raste edhe Komiteti i Parandalimit të Torturës (CPT) të Këshillit të Europës është shprehur se, *praktika e mbajtjes së prangosur në spital e personave të burgosur është një akt degradues ndaj individëve dhe duhet zëvendësuar me masa të tjera alternative sigurie.* Në mënyrë të qartë një qëndrim i tillë është mbajtur në Raportin e Dytë të Përgjithshëm të KPT-së (CPT/inf (92)3), ku midis të tjerash thuhet se, citojmë: *“Të burgosurit e dërguar në spital për t’u trajtuar nuk duhet të lidhen fizikisht në shtretërit e tyre të spitalit ose në pajisje të tjera për arsye ruajtje. Mundet dhe duhet të gjenden mjete të tjera që të plotësojnë kënaqshëm nevojat e sigurisë”.* Ky përfundim ka ardhur si rezultat i shumë konstatimeve të këtij Komiteti gjatë vizitave në vendet anëtare të Këshillit të Europës, ku objekt ka qenë trajtimi i personave të kufizuar nga liria.

Në përfundim të hetimit administrativ të këtij rasti kemi arritur në konkluzionin se, mbajtja lidhur me pranga pas krevatit e të paraburgosurve ose e të burgosurve të sëmurë në spitale, përbën shkelje e drejtës themelore e garantuar nga neni 25 i Kushtetutës dhe neni 3 i Konventës Europiane e të Drejtave të Njeriut, *për mos ju nënshtruar torturës, dënimit apo trajtimit mizor, çnjerëzor ose poshtëruës.*

Për sa më sipër, bazuar në pikën 3, të nenit, 63 të Kushtetutës tonë ku thuhet se: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike”;* në nenin 24/b, të Ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999 *“Për Avokatin e Popullit”*, të ndryshuar, në të cilin thuhet se: *“Kur Avokati i Popullit vëren se është vetë përmbajtja e ligjit ose e akteve të tjera normative dhe jo zbatimi*

i tyre shkakut që krijon premisa për shkelje të të drejtave të njeriut, të njohura nga Kushtetuta ose ligjet e tjera, ka të drejtë:

b. t'u propozojë organeve të administratës ndryshimin ose përmirësimin e akteve nënligjore; mosshqyrtimi i propozimit brenda 30 ditëve sjell si pasojë pezullimin e fuqisë së akteve nënligjore që shkaktojnë shkelje të të drejtave dhe lirive”, si dhe në vijim të përmbushjes së detyrimeve që burojnë nga “Protokolli Opsional i Konventës kundër Torturës dhe Ndëshkimeve të tjera Çnjerëzore dhe Degraduese (OPCAT)”, i cili është ratifikuar nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë me Ligjin nr. 9094 datë 03.07.2003,

REKOMANDOJMË:

Marrjen e masave të menjëhershme për ndryshimin dhe përmirësimin e dispozitave të Rregullores “Për rregullat e hollësishme të sjelljes së punonjësve të Policisë së Burgjeve”, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Drejtësisë nr. 5251/2, datë 30.07.2010 dhe konkretisht:

a) Në nenin 30 (shoqërimi dhe transferimi i të burgosurve), pika 3, gërma “sh” e saj, e cila bën fjalë për shoqërimin e të burgosurit në spitale, ku parashikohet se: *“I burgosuri i sëmurë, mbahet i lidhur me pranga nga njëra dorë ose këmbë, me hekurin e krevatit”.*

b) Në nenin 30 (shoqërimi dhe transferimi i të burgosurve), pika 3, gërma “t” e saj, ku parashikohet se: *“Të burgosurit të sëmurë i hiqen prangat, kur e lëvizin nga dhoma, kur mjeku i bën vizitë ose në rastet e gjendjes së rëndë shëndetësore, sipas konfirmimit të mjekut përkatës”.*

Për shqyrtimin e këtij rekomandimi dhe qëndrimin që do të mbani ndaj tij, të vihemi në dijeni brenda afatit ligjor prej 30 ditësh, konform nenit 22 të Ligjit “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,

AVOKATI I POPULLIT

Igli TOTOZANI